



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

V E N D I M

Nr. 217, datë 28.12.2017

MBI

FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2018

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Fondi i Kompensimit krijohet bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur dëmet shkaktohen nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i siguruar sipas ligjit nga ndonjë shoqëri sigurimi, nga një mjet motorik i pidentifikuar apo në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi.

Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3, shkronja b e këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Referuar pikës 5 të nenit 3, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, si dhe pikës 1 të nenit 7, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”, e ndryshuar, Byroja brenda datës 30 nëntor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit shumën e kontributeve të çdo shoqërie sigurimi për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës.

Autoriteti miraton çdo vit brenda datës 31 dhjetor, shumën e këtyre kontributeve.

Autoriteti me shkresën nr. 3348, prot, datë 04.12.2017 i ka dërguar shkresë BSHS, duke i rikujtuar detyrimin që duhet të depozitonte në Autoritet propozimin për Fondin e Kompensimit të vitit 2018, brenda datës 30 nëntor 2017.

Në shkresë citohet se Autoriteti nisur nga situata e detyrimeve të Fondit të Kompensimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në mbledhjen e muajit dhjetor do të vendosë mbi shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit për vitin 2018.

Byroja Shqiptare e Sigurimit më datë 18.12.2017, zhvilloi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, ku u propozua krijimi i Fondit të Kompensimit për vitin 2018, i ndarë në dy komponentë:

- Shuma prej 500,000,000 lekë – për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit deri më datë 31.12.2013;
- Shuma minimale prej 150,000,000 lekë - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, nr. 26, datë 18.12.2017 “Për miratimin e masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2018”, është depozituar nëpërmjet email-it vetëm më datë 27.12.2017.

Referuar të dhënave në vite dhe raportimeve nga Byroja, Fondi i Kompensimit ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe detyrimet e mbartura të akumuluar në vite, përkatësisht detyrimet për “Dëme të miratuara, të papaguara”, deri më 31.11.2017 për ngjarjet nga 01.01.2001 - 31.12.2013, vlerësohen të jenë minimalisht 817,488,325 lekë dhe detyrimet për “Dëme të miratuara, të papaguara”, deri më 30.10.2017 për ngjarjet nga 01.01.2014 - 31.10.2017, vlerësohen të jenë minimalisht 105,866,433 lekë.

Ndërsa, vlera për “Dëme në proces të papaguara”, për ngjarjet nga 01.01.2001 - 31.12.2013 vlerësohen të jenë 433,123,913 lekë dhe për ngjarjet nga 01.01.2014 - 31.10.2017, vlerësohen të jenë 312,079,181 lekë.

Në funksion të misionit të AMF-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, problematikave ndër vite në tregun e sigurimeve me Fondin e Kompensimit, vlerësohet se shuma e propozuar nga BSHS-ja është e pamjaftueshme. Shuma e propozuar nga Byroja në vlerën 500 milion lekë për pagesën e dëmeve me ngjarje sigurimi deri më 31.12.2013 dhe në vlerën 150 milion lekë për pagesën e dëmeve me ngjarje sigurimi pas datës 1 janar 2014, e në vazhdim, është e vogël krahasuar me vlerën e detyrimeve të mbartura të akumuluar në vite, e cila sipas statusit të praktikës së dëmit dhe vlerave përkatëse (në lekë), paraqitet si më poshtë:

Sipas statusit të praktikës	Ngjarje deri 31.12.2013	Ngjarje pas 1 janar 2014
1. Dëme të miratuara por të papaguara	817,488,325	105,866,433
1.1 Dëme të miratuara por të pa paguara	82,515,266	93,252,747
1.2 Dëme me vendime gjyqësore të formës së prerë	637,426,463	0
1.3 Gjyqësore Shkallë e lartë	97,546,598	12,613,686
2. Dëme në proces të papaguara	433,123,913	312,079,181
2.1 Dëme në proces trajtimi	11,065,315	137,163,466
2.1 Dëme në proces gjyqësor	422,058,598	174,915,715
<i>Detyrimi për Dëme Pezull Fond Kompesimi</i>	<i>1,250,612,240</i>	<i>417,945,614</i>

Vlerat totale të detyrimeve të mbartura të akumuluar në vite, të cituara më sipër priten të ndryshojnë si rrjedhojë e mospërfshirjes së vlerave të dëmeve të ndodhura, por të paraportuara,

për ngjarjet pas 1 janar 2014, si dhe në përputhje me të dhënat e certifikuara nga shoqëria audituese e jashtme.

Pas shqyrtimit të propozimit të BSHS-së, bërë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, të datës 18.12.2017 dhe vlerësimeve të kryera nga AMF-ja, masa e Fondit të Kompensimit për detyrimet e mbartura dhe që do të lindin për vitin 2018, vlerësohen **minimalisht në masën 1,818,557,854 lekë, e ndarë:**

- **1,668,557,854 lekë**, (1,250,612,240 lekë për ngjarjet nga 01.01.2001 – 31.12.2013 dhe 417,945,614 lekë për ngjarjet nga 1 janar 2014 e në vazhdim). Nga kjo vlerë për pagesa të menjëhershme për të dy periudhat është vlera prej 923,354,758 lekë (817,488,325 lekë për ngjarjet nga 01.01.2001 – 31.12.2013 dhe 105,866,433 lekë për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim);
- **Minimalisht 150,000,000 lekë** për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi nga 01.01.2018 - 31.12.2018.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Për vitin 2018, Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve të krijohet minimalisht në masën 895,203,094 lekë, i ndarë në tre komponentë:
 - 1.1 Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull (në proces trajtimi apo proces gjyqësor) me datë ngjarje sigurimi nga 01.01.2001 deri në 31.12.2013, të jetë në vlerën 433,123,913 lekë;
 - 1.2 Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull (në proces trajtimi apo proces gjyqësor) me datë ngjarje sigurimi nga 1 janar 2014 e në vazhdim të jetë në vlerën 312,079,181 lekë;
 - 1.3 Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve me datë ngjarje sigurimi nga 01.01.2018 – 31.12.2018, të jetë në vlerën minimale prej 150,000,000 lekë.
2. Të urdhërojë Byronë Shqiptare të Sigurimit për ndjekjen e procedurës të shlyerjes menjëherë për pagesat e praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit (përmbarimore, me vendim gjykate të formës së prerë dhe të miratuara por të papaguara) në vlerën 923,354,758 lekë, si më poshtë:
 - 2.1 Në vlerën 817,488,325 lekë, për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në 31.12.2013;
 - 2.2 Në vlerën 105,866,433 lekë, për ngjarjet e sigurimit nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

3. Byroja Shqiptare e Sigurimit :

- 3.1 Të shpërndajë te shoqëritë e sigurimit dhe të autorizojë për pagesë praktikat objekt i Fondit të Kompensimit të vitit 2018, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të cilat përfundojnë procesin e trajtimit apo ka vendim gjyqësor të formës të prerë.
- 3.2 Të shpërndajë menjëherë për pagesë te shoqëritë e sigurimit praktikat të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij vendimi dhe të autorizojë për pagesë të menjëhershme.

4. Byroja Shqiptare e Sigurimit:

- 4.1 Të llogaritë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për krijimin e Rezervës mbi Fondin e Kompensimit;
 - 4.2 Të depozitojë në AMF brenda datës 25 janar 2018 planin e shpërndarjes së detyrimeve për dëme objekt i Fondit të Kompensimit, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, për çdo shoqëri të detajuar sipas vlerës dhe vitit të ngjarjes së sigurimit;
 - 4.3 Të raportojë çdo muaj në AMF, brenda datës 10 të muajit pasardhës, evidencat për ecurinë e dëmeve të raportuara, të miratuara dhe në proces, pagesat e dëmeve për çdo shoqëri dhe sipas vitit të ngjarjes së sigurimit, financimin e Fondit të Kompensimit për çdo shoqëri dhe detyrimin e mbetur pa financuar për çdo shoqëri sigurimi, si dhe për llogaritjen dhe krijimin e Rezervës për Fondin e Kompensimit ;
 - 4.4 Të bëjë çdo tre muaj rakordimet për pagesat dhe detyrimet objekt i Fondit të Kompensimit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, dhe të raportojë në AMF.
5. Vlerat e detyrimeve të përcaktuara sipas pikave 1.1 dhe 1.2 dhe 2 të këtij vendimi do të rishikohen në përfundim të procedurës së auditimit me objekt Fondin e Kompensimit.
 6. Fondi i Kompensimit i parashikuar për vitin 2018 sipas pikës 1 të këtij vendimi do të rishikohet në fund të çdo tremujori nëse rezulton i pamjaftueshëm.
 7. Ngarkohen Departamenti i Çështjeve Juridike, Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet e këtij vendimi dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për ndjekjen e raportimeve, kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI